

2636/7
12
17.07.2023



02.5
1110/6
PO

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit
Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra Ligjore - Pravna Kancelarija - Legal Office

REFERENCË:	397 1110/3-2023
DATË:	13.07.2023
PËR/ZA/TO:	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor/MBPZHR.
CC:	Arben Krasniqi, Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm/ZKM; Novitet Nezaj, Drejtor i Departamentit të së Drejtës së BE-së/ZKM; Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore/ZKM; Blerim Hasani, Sekretar i Përgjithshëm/MBPZHR.
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arben Krasniqi, zv. Sekretar i Përgjithshëm / Zyra e Kryeministrit; Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore / Zyra e Kryeministrit.
NGA/OD/FROM:	Labinote Kashtanjeva, zv. Udhëheqëse e Divizionit për Çështje Ligjore të BE-së / Zyra Ligjore / Zyra e Kryeministrit.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shkresa përcjellëse për <i>Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës e Përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft für Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për Projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale Përmes Diversifikimit të Aktiviteteve</i>

I nderuar Z. Rudaku
Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Rregulloren nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenin 8 par 2.16 si dhe nenin 12 par 1.1 të Rregullores (ZKM) Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, ju përcjellim Opinionin Ligjor të Përputhshmërisë me *acquis* të BE-së për *Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës e Përfaqësuar nga Ministria*

e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft für Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për Projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale Përmes Diversifikimit të Aktiviteteve.

Me respekt!



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada Government

Zyra e Kryeministrit

Kancelarija Premijera – Office of the Prime Minister

Zyra Ligjore – Pravna Kancelarija – Legal Office

OPINIONI LIGJOR I PËRPUTHSHMËRISË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

13.07.2023

Departamenti Ligjor i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datë 3 korrik 2023, bazuar në nenin 7, nënparagrafin 1.2 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe nenit 13, paragrafit 5 të Rregullores Nr. 13/2023 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, si dhe në pajtim me nenin 12, paragrafin 3 dhe 4, nënparagrafin 4.19 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 për Fushat e Përgjegjësisë të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, ka dorëzuar për shqyrtim në Divizionin e të Drejtës së BE-së, në Zyrën e Kryeministrit “*Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës e Përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft für Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për Projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale Përmes Diversifikimit të Aktiviteteve*”.

1. SUBJEKTI

Opinion Ligjor për Përputhshmërinë e “*Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, e Përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ,dhe Deutsche Gesellschaft für Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për Projektin Mbështetja për*

Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale Përmes Diversifikimit të Aktiviteteve”, me *acquis* të BE-së.

2. DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA

Në kërkesën e Departamentit Ligjor të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për Opinion Ligjor të Përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, janë dërguar këto dokumente:

- Drafti Përfundimtar i *Projektligjit* (versioni i gjuhës shqipe, serbe, dhe gjuhës angleze);
- Deklarata e Përputhshmërisë;
- Memorandumi Shpjegues.

3. PREAMBULA

Në pajtim me nenin 7, paragrafin 3 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nenit 3, nënparagrafit 1.3, nenit 13, paragrafi 6, si dhe nenit 21, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenit 30, paragrafit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Divizioni i së Drejtës së BE-së, së Zyrës së Kryeministrit, bazuar në fushëveprimin e kompetencave të tij, me datë 13 korrik 2023, lëshon këtë:

4. OPINION LIGJOR PËR PËRPUTHSHMËRINË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

Kërkesa për **Opinion Ligjor** me *acquis* të BE-së është dërguar në dosje fizike dhe elektronike me datën 3 korrik 2023, me numër të referencës 1110-3.

5. HYRJE

Qëllimi i këtij *Projektligji* është ratifikimi i Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, e Përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft Für Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për Projektin Mbështjetja për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale përmes Diversifikimit të Aktiviteteve.¹

¹ Neni 1 i *Projektligjit*.

6. PËRMBLEDHJA E AKTEVE TË BE-SË QË RREGULLOJNË FUSHËN E PROJEKT-AKTIT NORMATIV

Korniza legjislativë në kuadër të politikave të përbashkëta bujqësore është e përcaktuar me *acquis* të BE-së. Rrjedhimisht, kjo fushë është e rregulluar me legjislacionin primar dhe sekondar të BE-së. Në nivel të legjislacionit primar, **Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE)², Titulli III – Bujqësia dhe Peshkimi, neni 38, paragrafi 1, përcakton:**

“Bashkimi vendos dhe zbaton një politikë të përbashkët për bujqësinë dhe peshkimin.”

Neni 39 përcakton objektivat e politikës së përbashkët bujqësore:

- (a) *“Rritja e prodhimit të bujqësore përmes nxitjes së përparimit teknik dhe përmes sigurimit të zhvillimit racional të prodhimit bujqësor dhe shfrytëzimit optimal të faktorëve të prodhimit, sidomos të krahut të punës;*
- (b) *Sigurimi, kështu, i një standardi të drejtë jetese për komunitetin bujqësor, sidomos përmes rritjes së fitimeve individuale të personave që merren me bujqësi;*
- (c) *Stabilizimi i tregjeve;*
- (d) *Garantimi i gatishmërisë së furnizimeve;*
- (e) *Sigurimi që produktet të shkojnë te konsumatori me çmime të arsyeshme.”*

Ndërsa, neni 41 parashikon masat që nevojiten për arritjen e objektivave të parashikuara në nenin 39, në kuadër të politikës së përbashkët bujqësore:

[Neni 41]

“Për të mundësuar arritjen e objektivave të parashikuara në nenin 39, brenda kuadrit të politikës së përbashkët bujqësore parashikohen masa të tilla si:

² E qasshme përmes: Versioni i Konsoliduar i Traktatit

- (a) *Bashkërendim i efektshëm i përpjekjeve në sferat e formimit profesional, kërkimit dhe përhapjes së njohurive bujqësore; kjo mund të përfshijë financim të përbashkët të projekteve ose institucioneve;*
- (b) *Masa të përbashkëta për nxitjen e konsumimit të produkteve të caktuara.”*

Në kuadër të Politikës së Përbashkët Bujqësore, legjislacioni i BE-së ka shtrirje të gjerë horizontale legjislative që rregullon fushën e CAP.³ Instrumentet kyçe legjislative në kuadër të Politikës së Përbashkët Bujqësore janë:

I. Rregullorja (BE) 2021/2116 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 2 dhjetor 2021 për financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikës së përbashkët bujqësore;⁴

– Kjo Rregullore vendos rregullat mbi financimin, menaxhimin dhe monitorimin e Politikës së Përbashkët Bujqësore, veçanërisht në:

- (a) *Financimin e shpenzimeve në kuadër të CAP;*
- (b) *Sistemin e menaxhimit dhe kontrollit që duhet të vendoset nga Shtetet Anëtare;*
- (c) *Procedurat e zhdoganimit dhe konformitetit.*

II. Rregullorja (BE) 2021/2115 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 2 dhjetor 2021 që përcakton rregullat për mbështetjen për planet strategjike që do të hartohen nga Shtetet Anëtare sipas politikës së përbashkët bujqësore (Planet Strategjike të CAP) të garantuara nga Fondi Evropian për Garanci Bujqësore dhe nga Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural;⁵

– Kjo Rregullore vendos rregullat mbi:

- (a) *Objektivat specifike dhe gjenerale që duhen të ndiqen nëpërmjet mbështetjes së Bashkimit të financuar nga Fondi Evropian i Garancisë Bujqësore dhe nga Fondi Evropian*

³ Common Agriculture Policy (Politika e Përbashkët Bujqësore).

⁴ E qasshme përmes: Rregullorja (BE) 2021/2116 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit

⁵ E qasshme përmes: Rregullorja (BE) 2021/2115 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit

Bujqësor për Zhvillimin Rrural nën politikën e përbashkët bujqësore (CAP) si dhe treguesit përkatës;

- (b) Llojet e ndërhyrjeve dhe kërkesat e përbashkëta për Shtetet Anëtare për të ndjekur këto objektiva, si dhe marrëveshjet financiare përkatëse;*
- (c) Planet Strategjike të CAP, të cilat duhet të hartohen nga Shtetet Anëtare dhe të cilat përcaktojnë objektiva, specifikojnë kushtet për ndërhyrje dhe shpërndajnë burime financiare, sipas objektivave specifike dhe nevojave të identifikuara;*
- (d) Koordinimin dhe qeverisjen si dhe monitorimin, raportimin dhe vlerësimin.*

III. **Rregullorja (BE) 2021/2117** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 2 dhjetor 2021 që ndryshon Rregulloret (BE) Nr. 1308/2013 mbi krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore, (BE) Nr. 1151/2012 për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore, (BE) Nr. 251/2014 për përcaktimin, përshkrimin, paraqitjen, etiketimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografikë të produkteve të verës së aromatizuar dhe (BE) Nr. 228/2013 që përcakton masat specifike për bujqësinë në rajonet më të largëta të Bashkimit.⁶

Këto nisma legislative janë pjesë e reformës mbi Politikën e Përbashkët Bujqësore e cila ka hyrë në fuqi me datë 1 Janar 2023, e cila hap rrugën që Politika e Përbashkët Bujqësore të jetë më e drejtë, më e gjelbërt dhe e bazuar në performancë.

Për më shumë, në kuadër të përafrimit me *acquis* të BE-së, Republika e Kosovës ka obligime ndërkombëtare që lindin nga **Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA)** e cila përcakton detyrime për përafrim dhe bashkëpunim në kuadër të fushëveprimit të *Projektligjit*.⁷

Neni 102 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit definon bashkëpunimin e Palëve në fushën e bujqësisë dhe sektorit agro-industrial:

⁶ E qasshme përmes: [Rregullorja \(BE\) 2021/2117 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit](#)

⁷ Ligji Nr. 05/L-069 për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, Gazeta Zyrtare: 34/2015, Data e publikimit: 01.12.2015, e qasshme përmes: <https://qzk.rks-gov.net/actdetail.aspx?actid=11239>

“Bashkëpunimi mes Palëve do të zhvillohet në të gjitha fushat prioritare që lidhen me acquis e BE-së në fushën e bujqësisë, si dhe skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe produktet ushqimore, sigurinë ushqimore, veterinarë dhe fushat fitosanitare. Bashkëpunimi do të ketë si synim veçanërisht modernizimin dhe ristrukturimin e sektorit të bujqësisë dhe sektorit agro-industrial në Kosovë, posaçërisht që të arrij kërkesat sanitare të BE-së, të përmirësojë menaxhimin e ujit dhe zhvillimit rural si dhe të zhvillojë aspektet e lidhura me sektorin e pylltarisë në Kosovë dhe të mbështesë përafrimin gradual të legjislacionit dhe praktikave të Kosovës me acquis të BE-së.”

Për më shumë, **neni 100 i MSA-së** definojnë bashkëpunimin në mes të Palëve me synim të zhvillimit dhe forcimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme:

“Bashkëpunimi mes Palëve do të synojë zhvillimin dhe forcimin e Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në sektorin privat, duke inkurajuar një mjedis të favorshëm për nismën dhe zhvillimin e ndërmarrjeve, veçanërisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe inkurajimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunim ndërmjet ndërmarrjeve. Bashkëpunimi duhet të jetë në përputhje me parimet e Aktit të Biznesit të Vogël dhe të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me acquis të BE-së në fushën e NVM-ve.”

Gjithashtu, **Titulli IX i MSA-së, neni 121, neni 123, dhe 125** përcaktojnë dispozitat relevante në kuadër të Bashkëpunimit Financiar:

[Neni 121]

“Për të arritur objektivat e kësaj marrëveshjeje dhe në përputhje me nenet 7, 122 dhe 123 dhe 125 Kosova mund të marrë asistencë financiare nga BE-ja në formë grantesh dhe huash, duke përfshirë huat nga Banka Evropiane e Investimeve. Ndihma financiare e BE-së kushtëzohet me përparimin e mëtutjeshëm në përmbushjen e kritereve politike të Kopenhagës. Duhet, po ashtu, të merret në konsideratë përmbushja e detyrimeve të Kosovës me këtë marrëveshje si dhe raportet vjetore të progresit për Kosovën. Ndihma financiare e BE-së, po ashtu, do t'i

nënshtrohet kushtëzimeve të PSA-së, në veçanti sa i përket angazhimit të përfituesit për të kryer reformat demokratike, ekonomike dhe institucionale. Ndihma financiare që i jepet Kosovës do të orientohet drejt nevojave të konstatuara, prioriteteve të pajtuara dhe kapacitetit për të thithur dhe për të dhënë rezultate si dhe masave të marra për të reformuar dhe për të ristrukturuar ekonominë.”

[Neni 123]

“Asistenca financiare mund të mbulojë të gjithë sektorët e bashkëpunimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, përafrimit të legjislacionit me acquis të BE-së, zhvillimit socio-ekonomik, qeverisjes së mirë, reformës së administratës publike, energjisë dhe bujqësisë.”

[Neni 125]

“Me qëllim që të mundësohet përdorimi sa më optimal i burimeve ekzistuese, Palët do të sigurohen që asistenca financiare e BE-së të jepet në bashkëpunim të ngushtë me atë nga burimet e tjera si ato prej shteteve anëtare, vendeve të tjera jashtë BE-së dhe institucioneve financiare ndërkombëtare.”

7. PËRSHKRIMI DHE VLERËSIMI I DOKUMENTEVE TË DËRGUARA ME LEGJISLACIONIN E PROPOZUAR NGA INSTITUCIONI I LINJËS

Nga aspekti përmbajtësor

Ky *Projektligj* ka për qëllim që të ratifikojë Marrëveshjen në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft Für Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për Projektin Mbështjetja për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale përmes Diversifikimit të Aktiviteteve. Qëllimi kryesor i projektit të mbështetur nga fondi është të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik rural përmes diversifikimit të aktiviteteve në zonat rurale me qëllim të zgjerimit dhe përshpejtimin të mundësive të punësimit dhe qëndrueshmërisë së fermave, në zonat më pak të favorshme në Kosovë. Kjo Marrëveshje Ndërkombëtare është në kuadër të projektit “*Promovimi i*

Ndërmarrësisë”, e cila kontribuon në forcimin e lidhjeve ekonomike me tregun e përbashkët të BE-së dhe e cila mbështet Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në rritjen e konkurrencës së tyre dhe gradualisht ndihmon në krijimin e një mjedisi më të mirë biznesi, objektiv kyç i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe procesit të vazhdueshëm të përafrimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës.⁸ Në kuadër të përafrimit të legjislacionit në fushën e bujqësisë, Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural është pjesërisht në pajtueshmëri me këto akte të BE-së:⁹

- **Rregulloren (BE) Nr. 1305/2013** të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, për mbështetjen e zhvillimit rural nga Fondi Bujqësor Evropian për zhvillim rural;
- **Rregulloren (BE) Nr. 1307/2013** të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, që përcakton rregullat për pagesat direkte për fermerët sipas skemave të mbështetjes në kuadër të politikës së përbashkët bujqësore;
- **Rregulloren (BE) Nr. 1306/2013** të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, për financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikës së përbashkët bujqësore;
- **Rregulloren (BE) Nr. 1308/2013** të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, që themelon organizimin e përbashkët të tregjeve në produktet bujqësore;
- **Rregulloren zbatuese të Komisionit (KE) Nr. 447/2014**, të datës 2 maj 2014, për rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) Nr. 231/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për krijimin e Instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II);
- **Direktivën 2001/18/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit**, të datës 12 mars 2001, për lëshimin e qëllimshëm në mjedis të organizmave të modifikuar gjenetikiisht;
- **Rregulloren (BE) Nr. 1144/2014** të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 22 tetor 2014, për masat e ofrimit dhe promovimit të informacionit në lidhje me produktet bujqësore të zbatuara në tregun e brendshëm dhe në vendet e treta;
- **Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 834/2007** të datës 28 qershor 2007, për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike;

⁸ *Shih Shtojcën e Marrëveshjes – Informata të Përgjithshme*

⁹ *Ligji Nr. 08/L-072, i qasshëm përmes: Ligji Nr. 08/L-072*

- Rregulloren (BE) Nr. 1151/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 21 nëntor 2012, për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe produktet ushqimore;
- Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 1217/2009 të datës 30 nëntor 2009, për krijimin e një rrjeti për mbledhjen e të dhënave të kontabilitetit për të ardhurat dhe operimin e biznesit të fermave bujqësore në Komunitetin Evropian.

Fushëveprimi i Marrëveshjes ndërlidhet ngushtë po ashtu me **nenet 100, 102, 121, 123, dhe 125** të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Këto nene përgjithësisht përcaktojnë obligimet ndërkombëtare të Kosovës në kuadër të MSA-së, specifikisht në fushat e bashkëpunimit në fushën e bujqësisë, zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar financiar. Gjithashtu, asistenca financiare që derivon nga Marrëveshja është e përcaktuar edhe me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, **nenin 16** ku përcaktohet se nga kush mund të financohen masat e politikës bujqësore.

Nga aspekti teknik

Dokumentacioni shoqërues është përgjithësisht në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative dhe me Udhëzimet Praktike për Përafrimin e Legjislacionit të Republikës së Kosovës me Legjislacionin e BE-së.

8. OPINIONI I PËRPUTHSHMËRISË

Ky **Opinion** i Përputhshmërisë është bazuar në përmbajtjen e draftit të projekt-aktit. Përgjegjësia e Divizionit për të Drejtën e BE-së në ZL/ZKM vihet në dukje me opinionin e saj, ndërsa institucioni propozues, është përgjegjës të plotësojë Deklaratën e Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelat e Përputhshmërisë (TeP), atëherë kur projekt-akti ndërlidhet me transpozim të *acquis* së BE-së. Institucionet e linjës janë përgjegjëse për politikën që ato bëjnë dhe për shkallën e harmonizimit me *acquis* të BE-së. Prandaj, periudhat paraprake nga transpozimi i pjesërishëm deri në transpozim të plotë janë përgjegjësi e organit propozues të projekt udhëzimit. Paraprakisht, plotësimi dhe përcaktimi i nivelit të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, është përgjegjësi e institucioneve të linjës. *Manuali për Plotësimin e Tabelave dhe Deklaratës së Përputhshmërisë dhe Udhëzime Praktike për Përafrimin e Legjislacionit të Republikës së*

Kosovës me Legjislacionin e Bashkimit Evropian, përmbajnë udhëzime praktike për këtë proces.¹⁰

9. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Fushëveprimi i *Projektligjit* është ratifikimi i *Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, e Përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft Für Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për Projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale përmes Diversifikimit të Aktiviteteve*. Konsideruar që objekt shqyrtimi për përputhshmërinë me *acquis* të BE-së është një Marrëveshje Ndërkombëtare, në këtë rast nuk kërkohet përpilimi i Tabelave të Përputhshmërisë. Ndonëse fushëveprimi i Marrëveshjes në tërësinë e saj nuk transponon *acquis* të BE-së, Marrëveshja ka ndërlidhje dhe implikime direkte në fushën e përafrimit të legjislacionit. Konform pikës 7 të këtij **Opinionit të Përputhshmërisë**, fushëveprimi i Marrëveshjes ka ndërlidhje ligjore tek dispozitat e MSA-së. Sipas Shtojcës së Marrëveshjes, një nga objektivet kryesore të Projektit për Promovimin e Ndërmarrësisë është fuqizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Si e tillë, Marrëveshja ka ndërlidhje direkte me nenin 100 – Bujqësia dhe Sektori Agro-industrial dhe me nenin 102 – Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, të MSA-së. Për më shumë, konform nenit 121 të MSA-së për Bashkëpunimin Financiar, asistencë financiare mund të kushtëzohet me përparimin e mëtutjeshëm të përafrimit të legjislacionit. Kurse neni 123 i MSA-së përfshinë fushat sektoriale që mund të mbulohen nga asistencë financiare, duke përfshirë këtu fushën e përafrimit të legjislacionit në kuadër të fushës së zhvillimit socio-ekonomik dhe bujqësor. Si të tilla, këto dispozita janë në përputhje me objektivat dhe synimet e Marrëveshjes për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik rural përmes diversifikimit të aktiviteteve në zonat rurale me qëllim të zgjerimit dhe përshpejtimit të mundësive të punësimit dhe qëndrueshmërisë së fermave, në zonat më pak të favorshme në Kosovë.

Me respekt,
Labinote Kashtanjeva

Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Çështje Ligjore të BE-së
Divizioni për të Drejtën e BE-së
Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit

¹⁰ E qasshme përmes: <http://mei-ks.net/sq/dokumente-udhzuese-mbi-procesin-e-prafrimit-ligjor>